

# BULETINI

MARS 2025



*Me kënaqësi ju paraqesim numrin jubilar të 50-të të buletinit të OJQ-së ACDC. Gjatë viteve të kaluara, buletini është bërë një pjesë e rëndësishme e organizatës sonë, duke na mundësuar të prezantojmë aktivitetet, arritjet dhe temat që janë të rëndësishme për komunitetet në Kosovë.*

# #50

*Përderisa e nisëm buletin në janar të vitit 2021, qëllimi ynë ishte të përmirësojmë informimin rreth aktiviteteve dhe arritjeve tona, por edhe të forcojmë bashkëpunimin me komunitetin, partnerët dhe donatorët. Gjatë 50 numrave, buletini është zhvilluar në një kanal kyç komunikimi që pasqyron drejtimit strategjike të organizatës sonë.*

*Përveçse shërben si mjet informimi, buletini është edhe një arkivë e punës sonë – një pasqyrim i përparimit dhe qëllimeve të arritura me kalimin e kohës. Ne e kemi përmirësuar vazhdimisht atë që aktivitetet tona të jenë më të dukshme për publikun e gjerë dhe që t'i prezantojmë më mirë temat kyçe me të cilat merremi.*

*Numri jubilar i 50-të i buletinit na motivon edhe më shumë që të vazhdojmë ta zhvillojmë atë dhe të zbatojmë aktivitete që kontribuojnë në forcimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut në Kosovë.*





## KLUBI GJUHËSOR NË GRAÇANICË DHE MITROVICËN E VERIUT

Në mars, OJQ ACDC organizoi klube gjuhësore në Graçanicë dhe Mitrovicën e Veriut me qëllim të forcimit të shumëgjuhësisë, përmirësimit të komunikimit në mesin e të rinjve dhe nxitjes së mirëkuptimit ndëretnik. Me këtë rast, klubet tona gjuhësore patën edhe vizita të rëndësishme që kontribuan më tej në promovimin e kësaj nisme.



Graçanicë: Gjatë vizitës së tij në Kosovë, Arthur Erken, Drejtor Rajonal i IOM-it për Evropën dhe Azinë Qendrore, së bashku me Laura Lungarotti, Shefe e Misionit të IOM-it në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Koordinatore për Ballkanin Perëndimor, vizituan klubin gjuhësor në Graçanicë.

Mitrovicë e Veriut: Ambasadorë nga disa shtete, partnerë donatorë të Fondit të Kombeve të Bashkuara për Ndërtimin e Paqes, vizituan klubin gjuhësor në Mitrovicën e Veriut, ku u takuan me të rinj që përmes aktiviteteve shumëgjuhëshe zhvillojnë dialogun dhe kohezionin shoqëror.



## PROMOVIMI I PLATFORMËS PËR KONSULTIME PUBLIKE

Në mars, ACDC organizoi dy tryeza të rrumbullakëta të dedikuara promovimit të platformës për konsultime publike, me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e marrjes së vendimeve dhe forcimit të transparencës së institucioneve publike.



Tryeza e rrumbullakët në Graçanicë (13 mars) – Me qëllim të përmirësimit të përdorimit të platformës për konsultime publike në mesin e komuniteteve jo-shumicë, u mbajt një takim ku morën pjesë drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë, Habit Hajredini, përfaqësues të sektorit civil dhe aktivistë.

Prezantimi i platformës në Mitrovicën e Veriut (20 mars) – Tryeza e dytë e rrumbullakët u mbajt në hapësirat e ACDC-së, ku përfaqësues të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare diskutuan për përmirësimin e transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës. Drejtori i ACDC-së, Dušan Radaković, prezantoi karakteristikat kryesore të platformës, ndërsa Habit Hajredini dha një shpjegim të detajuar për procesin e regjistrimit dhe qëllimet kryesore të platformës.






## KULTURË DHE ART: HOLOPARTIZANKAT NË QKP "AKVARIJUS"

Më 6 mars, në Qendrën Kulturore Private "Akvarijus" në Mitrovicën e Veriut u shfaq një shfaqje inovative vallëzimi me titull Holopartizankat. Kjo instalacion unike koreografike bashkoi katër valltare njerëzore dhe katër holografike, duke eksploruar mënyrën se si narrativat historike formësojnë gjeneratat. Shfaqja është pjesë e një projekti të mbështetur nga Programi Zviceran për Bashkëpunim, me qëllim të nxitjes së shkëmbimit kulturor dhe dialogut përmes artit.



## ACDC NË PARTNERITET ME OJQ-NË REC: VIZITË NË TRASHËGIMINË KULTURORE TË PRIZRENIT

Në një ditë të ngrohtë pranvere, të rinjtë nga Mitrovica vizituan trashëgiminë kulturore të Prizrenit përmes një projekti që ACDC e realizon në bashkëpunim me OJQ-në REC dhe me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë. Vizita përfshiu monumente të tilla si Xhamia e Gazi Mehmet Pashës, Tekkeja e Tarikatit Halveti, Kisha e Shën Gjergjit dhe monumente të tjera, duke rikujtuar historinë e pasur dhe trashëgiminë e përbashkët kulturore.



Drejtori Ekzekutiv i ACDC-së, Dušan Radaković, mori pjesë në diskutimin “Pengesat ligjore dhe administrative në çështjet pronësore” të mbajtur në Prishtinë. Gjatë ngjarjes u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe sektorit civil për tejkalimin e pengesave dhe përmirësimin e qasjes në drejtësi për qytetarët e Kosovës.



Drejtori Ekzekutiv i ACDC-së, Dušan Radaković, gjithashtu mori pjesë në një takim ndërmjet Përfaqësueses së Posaçme të Sekretarit të Përgjithshëm (SRSG) dhe Shefes së UNMIK-ut, Caroline Ziadeh, dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Në takim u diskutuan zhvillimet e fundit dhe çështjet me rëndësi për komunitetin.



Dušan Radaković ishte i ftuar në TV Most në një emision të dedikuar zgjedhjeve parlamentare në Kosovë.

**LINK**



**ACDC ka publikuar tre tekste të reja:**

**“Arti si lojë politike” – analizë e rolit të artit në ndryshimet shoqërore dhe politike**

**“Fili xhe kafja ime” – tekst mbi normat shoqërore dhe dallimet kulturore përmes metaforës së kafesë**

**“Kultura si urë pajtimi” – si aktivitetet ndërkulturore të të rinjve përmes artit dhe shoqërimit ndihmojnë në kapërcimin e paragjytimeve**

Lexoni ato në faqen tonë të internetit!

SRB

ENG

ALB

**Njoftim për media:**

ACDC, së bashku me disa organizata të shoqërisë civile, ka publikuar një deklaratë publike lidhur me ndalimet e rastësishme të të miturve dhe anshmërinë etnike të Policisë së Kosovës.

SRB

ENG

ALB

**ACDC ka publikuar Raportin Vjetor për vitin 2024!**

Përmbledhja e aktiviteteve dhe arritjeve kryesore në fushat e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe bashkëpunimit ndëretnik është në dispozicion në gjuhën serbe, shqipe dhe angleze.

SRB

ENG

ALB



# KONTAKTI

✉ [office@acdc-kosovo.org](mailto:office@acdc-kosovo.org)

📷 [@acdc.kosovo](https://www.instagram.com/acdc.kosovo)

f [www.facebook.com/Ngoacdc](https://www.facebook.com/Ngoacdc)

✂ [@ngo\\_acdc](https://twitter.com/ngo_acdc)



[www.acdc-kosovo.org](http://www.acdc-kosovo.org)

